



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Data .04.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Sigurimi i pasurisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shehim për sigurimin në rast demit ose humbje – 66515000-3;
- Shërbime të sigurimit të pronës – 66515200-5;
- Shërbime të sigurimit – 79710000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **19.945.004 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e katër) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, si dhe neneve 26 e 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas referimeve në shtojcën 8 dhe shtojcën 9 të DST-ve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për te pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit, të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, në nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet format elektronikë", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesat e ligjit nr 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen

e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë kompani sigurimesh e pajisur me licence për ushtrim te aktivitetit per sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, dhe Aneksin bashkelidhur ku të jenë specifikuar qartë klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

Operatori ekonomik te kete ne Liçensen e ushtrimit te aktivitetit te tij klasat si me poshte:

Klasat 3, 7 dhe 10: Sigurimet motorrike.

Klasa 8: Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyres (te ndryshme nga ato

te perfshira ne klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7).

Klasa 9: Sigurimi i demtimeve te tjera te pasurise (te ndryshme nga ato te perfshira ne klasat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8).

Klasa 10: Sigurimi i pergjegjesive.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe neneve 41 e 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 23,pika 1 te ligjit 52/2014 “Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit”.

Licenca per ushtimin e aktivitetit dhe klasat e kerkuara nga AK jane mbeshtetur ne sigurimin e demit qe kerkohet ne ketë procedurë prokurimi, bazuar ne vleren e larte te shumave te sigurimit te percaktuara ne termat e references.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale si dhe klasat perkatese që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare).

2.3.3 Kontratë risigurimi të vlefshme përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës (dokument shoqërues i Risiguruesit, i cili duhet të jetë i klasifikuar në një kategori jo më të ulët se BBB nga Standard & Poor’s, apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY’S, AM BEST, për vitin 2021 ose 2022), në të cilën merret përsipër sigurimi i demit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.

SQARIM:

Vitet 2021 ose 2022, të vendosura në këtë kriter, i referohen standartit të klasifikimit të Shoqërive Risiguruese në kategorine jo më te ulët se BBB nga Standard & Poor’s (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY’S, AM BEST) dhe jo vlefshmërisë së kontratave risiguruese që, sigurisht, duhet të jenë të vlefshme përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës në fjalë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 116 te Ligjit nr.52/2014 dhe Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 ndryshuar nr.88 date 27.06.2016 neni 4, pika 1, germa a, “Për kriteret e risigurimit”.

2.3.4 Licencë për vlerësimin e dëmit, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Per permbushjen e ketij kriteri Operatoret Ekonomike duhet te paraqese kopje te noterizuar te “Licence per vleresimin e demeve materiale dhe shendetsore” te leshuar nga AMF, te personave te cilet ushtrojne veprimtarine si punonjes te shoqerise ose vlersues te pavarur qe kane kontrata bashkepunimi me to.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 226, pika 2 dhe neni 227, pika 1, te ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Me kete kriter kerkohet OE te deshmojne qe disponojne vleresues demesh te licencuar sipas legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

II. Argumentimi i termave te references

Shënim: Përcaktoni termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në termat e references, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

➤ Në fazën e dorëzimit:

1. Policat e sigurimit duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Përsa i perket raportimit, në rast ndodhje të ngjarjeve, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a. Caktimi i një personi kontakti për komunikim në çdo rast;
 - b. Mënyrën e raportimit në rast ndodhje të dëmit.
- **Afati i realizimit e plote te kontrates se sigurimit te pasurise se APD-se per vitin 2023 do te jete brenda 16 muajve dhe do te filloje nga data e prerjes se polices se pare. Perfundimi i afatit te kontrates se prokurimit do te jete data e perfundimit te afatit te sigurimit te polices se fundit, te prere, objekt i sigurimit te kesaj kontrate.**

Në dokumentet mbi Termat e Referencës dhe Listat me Objektet që do të Sigurohen, janë percaktuar, të detajuara të gjitha pikat dhe kriteret e specifikimeve teknike përkatëse, lidhur me objektin e kontratës së prokurimit “Sigurimi i pasurisë”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

KOMISIONI: